REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 17/17
Datë/Datum. 27-02-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 17/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi- Kryetar, z. Blerim Dina- Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "N. T. Info Com" me seli në Prishtinë, kundër AK– /Kuvendi i Republikës së Kosovës/, lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit "Mirëmbajtja, servisimi dhe furnizimi me toner për aparatet fotokopjuese të tipit "Canon", me nr. të prokurimit: KU/101/16/050/221", më datën 15. 02. 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "N. T. Info Com"- Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja, servisimi dhe furnizimi me toner për aparatet fotokopjuese të tipit "Canon", me nr. të prokurimit: KU/101/16/050/221".

II. **Anulohet,** vendimi i AK-së /Kuvendi i Kosovës/ për anulimin e aktivitetit të prokurimit "Mirëmbajtja, servisimi dhe furnizimi me toner për aparatet fotokopjuese të tipit "Canon" me nr. prok. KU/101/16/050/221, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues OE "N. T. Info Com" me seli në Prishtinë, konform nenit 118.3 të LPP-së i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është aprovuar e bazuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 20.09. 2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 12.10.2016, ku kanë marr pjesë një operatorë ekonomik.

Data e njoftimit të anulimit për aktivitetit të prokurimit në KRPP është bërë me datën 10.01.2017.

Ndërsa kundër vendimit për anulim operatori ekonomik "N. T. Info Com"- Prishtinë ka bërë kërkesë për rishqyrtim 13.01.2017

Me dt:16.01.2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "N. T. Info Com"- Prishtinë.

Operatori ekonomik "N. T. Info Com" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 19 janar 2017 me nr. 17/17, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Mirëmbajtja, servisimi dhe furnizimi me toner për aparatet fotokopjuese të tipit "Canon", me nr. të prokurimit: KU/101/16/050/221", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 7 i LPP-së- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 8.2 - Planifikimi i Prokurimit
- Neni 9.2 LPP-së- Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur
- Neni 10 i LPP-së – Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur
- Neni 16 i LPP-së – Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim
- Neni 18 i LPP-së- Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës së Punëve

- Neni 26 pika 2- Nënshkrimi i kontratave publike
- Neni 35 i LPP-së – Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës
- Neni 51 i LPP-së – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 52.3 i LPP-së – Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 56 i LPP-së- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 68 i LPP-së – Gjendja Ekonomike dhe Financiare
- Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 105- Kompetencat e OSHP-së
- Neni 108/A- Konfidencialiteti
- Neni 114 pika 2- Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues
- Neni 115 pika 4,5,6 -Vendimi i autoritetit kontraktues
- Neni 39 udhëzuesit Operativ për prokurim publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 03 shkurt 2017, i ka rekomanduar panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa Autoriteti Kontraktues të anuloj njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 10.01.2016, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik ankues "N. T. Info Com"- Prishtinë, me datë: 04 shkurt 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues me datë: 06 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertes shqyrtuese.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15. 02. 2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimin për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE "N. T. Info Com"- Prishtinë ka deklaruar: "Ne pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues. Gjitha kushtet e dosjes ne si OE i kemi plotësuar dhe më shumë se që është kërkuar. Çështja është se është një makinë e komplikuar që vetëm ne si OE jemi të autorizuar për mirëmbajtje të saj. Më herët kanë qenë kriteret për autorizim nga prodhuesi pasi ka pas OE që kanë marr kontrata mirëpo nuk kanë mund të bëjnë mirëmbajtjen. Ne kemi ofruar me kontrata dhe me fatura. Eksperti nuk ka llogaritur vitin 2016, mirëpo prapë plotësojmë kushtet e dosjes së tenderit. Kjo ka qenë arsyeja e vetme pse AK na ka eliminuar.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-Kuvendi i Kosovës ka deklaruar: "AK ofertën e OE ankues e ka vlerësuar me kujdes si të gjitha ofertat. Duhet bërë një dallim mes ofertës dhe OE, ne kemi vlerësuar ofertën e OE. Oferta është vlerësuar në pajtim me kërkesat e AK-së, dhe në pajtim me specifikat e lëndës ka vënë kriteret. Oferta e OE ankues, duhet lexuar me vëmendje, pasi kërkesë ka qenë "duhet të ketë kontrata të natyrës së njëjtë". Për këto raste kemi pyetur edhe KRPP dhe kanë thënë se vetëm tenderi në fjalë është në përputhje me gjitha kërkesat e dosjes. Oferta e OE ankues nuk ka përmbushur kërkesën për kontrata. Sipas asaj çka ka ofruar OE ankues nuk kemi pa të arsyeshme të shfrytëzojmë nenin 72, pasi me këtë nen dallohet se çka mund të kërkohet nga OE dhe për cilat dokumente. Me gjithë atë pas marrjes së vendimit të OSHP-së me cilin është kërkuar të shfrytëzohet neni 72 ne kemi respektuar vendimin dhe kemi ofruar komisioni tjetër të vlerësimit i cili ka trajtuar ofertën dhe ka dorëzuar raportin e vlerësimit në detale, ku shihet se me kontrata dhe referenca që ka ofruar nuk përmbush kërkesën në vlerë 130.000 €. Eksperti kontratat i trajton të natyrës së ngjashme, mirëpo kërkesë ka qenë kontrata të natyrës së njëjtë, dhe këtu duhet të bëhet dallimi. Ne nuk kuptojmë tendencën e OE që me çdo kusht të kaloj këtë lëndë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Lidhur me pretendimin e OE ankues që AK ka për kriterin 9.1 dhe 9.2 dhe ka kërkuar nga OE dëshmi se kanë përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë të përcjella me referenca tri të vite 2013-2014-2015 në vlerë 130.000€. OE konform nenit 72 ka plotësuar dhe sqaruar d rreth kriterit me kontrata dhe referenca si dhe pranuarat e pranimit të mallit të njëjta me këtë natyrë të prokurimit. OE ankues shihet që ka dëshmi se mbulon këtë kriter që ka ofruar kontrata dhe referenca me vlerë 199,738.82€. I sqaroj panelit se në bazë të dëshmive dhe kalkulimit te OE ankues Info Com, nuk kam marr parasysh kontratat dhe referencat e vitit 2016, por vetëm për vitet 2013-2014-2015. Në bazë të këtij kriteri OE ankues Info Com mbulon kërkesën e AK-së sepse sipas kalkulimit siç ceka potencuam 163,110.28 €. Kriteri i AK është minimumi 130.000 € dhe sipas dëshmive OE mbulon këtë kriter, pasi në kontrata ka pas edhe shërbime dhe furnizim. Andaj bazuar në këto që ceka kam rekomanduar që aktiviteti të kthehet në Rivlerësim pasi ka dëshmi se OE ankues plotëson këtë kriter".

Në vazhdim të seancës, anëtari i panelit shqyrtues z.Dina pyeti përfaqësuesin e AK-së, sipas titullit mirëmbajtja, servisimi dhe furnizimi me toner për aparate fotokopjuese të tipit Canon, sa është dashtë me qenë vlera furnizim, sa servisim, sa ka qenë bashkërisht, a keni cek në ndonjë pasus në dosje të tenderit se si duhet të jetë ndarja?

Në përgjigje përfaqësuesi i AK-së deklaroj: "Sipas specifikimit teknik shihet qartë që 90% e vlerës është servisim, ndërsa 10% mund të jetë vlerë e furnizimit. Primare në këtë procedurë – aktivitet të prokurimit është servisimi pajisjes e jo furnizimi me toner".

Gjithashtu anëtari i panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e AK-së, pasi deklaruat se keni pas për tri vite me OE ankues kontratë, a keni pas ndonjë vërejtje për shërbimet e kryera nga ky OE?.

Në përgjigje përfaqësuesi i AK-së deklaroj: "Kjo pyetje nuk është relevante me objektin e shqyrtimit tani.Ne nuk kontestojmë OE si kompani, mirëpo oferta e këtij OE për këtë aktivitet të prokurimit nuk përmbush kërkesat e AK-së në dosje të tenderit".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar: "Kërkojmë nga paneli shqyrtues të kthehet lënda në Rivlerësim konfrom dispozitave të LPP-së".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-Kuvendi i Kosovës ka deklaruar: "Ne qëndrojmë pranë vendimit të AK-së".

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve e rekomandimeve të dhëna në ekspertizë".

Lidhur me arsyetimin e AK-së, se OE ankues, nuk e ka plotësuar kërkesën e përcaktuar në piken 9.1 dhe 9.2 të FDT-së ku shkruan "OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë të përcjellura me referenca në tri vitet e fundit (2013, 2014,2015), në vlerë 130,000.00 euro, ku si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Një listë e cila paraqet secilën nga kontratat e shërbimeve kryesore përkatëse të përfunduara në tri vitet e fundit, ku është specifikuar: Data e përfundimit, lloji i shërbimeve të përfshira, pranuesi i shërbimeve, shuma e kontratës, referenca për këto kontrata të realizuara (ku në reference duhet bashkangjitur edhe vlerën e përfunduar e kontratës), min 130,000.00 euro, paneli shqyrtues sqaron se AK fillimisht ka zbatuar vendimin e OSHP-së me numër prot 391/16 të dt:16.12.2016, me ç'rast ka kërkuar nga OE ankues që konform nenit 72 të LPP-së ti plotësoj dhe të sqaroj kontratat dhe referencat sipas kërkesës së FDT-së tek pika 9.1 dhe 9.2.

Pas kërkesës për sqarime shtesë, operatori ekonomik ankues i ka ofruar dëshmitë siç janë kontrata, referencat si dhe faturat e pranimit të shërbimeve dhe furnizimeve, për tri vitet e fundit, konform nenit 72 të LPP-së, e që rezulton se OE ankues e plotëson kriterin e FDT-së konkretisht të parashikuar në nenin 9.1 dhe 9.2. Prandaj rezulton se AK-ja nuk i ka marr parasysh dëshmitë e ofruara të OE ankues sipas kërkesës dhe siç parashihet në nenin 72 të LPP dhe me këtë rast ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues njëkohësisht konstaton se mosmarrja parasysh e dëshmive dhe dokumenteve shtesë të ofruara nga OE ankues bie në kundërshtim me nenin 68 paragrafi 3 i LPP-së ku shkruan *"Nëse për ndonjë arsye të vlefshme, OE ankues nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga AK, operatorit ekonomik i lejohet që të demonstrojë gjendjen e vet ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër që AK, në ushtrimin e diskrecionit të tij të arsyeshëm e konsideron të përshtatshëm".*

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh dëshmitë dhe argumentet e prezantuara dhe të ofruara, konstaton se OE ankues ka realizuar qarkullim për tri vitet e fundit 2013,2014,2015, në vlerë prej: 163,110.28 euro. Paneli shqyrtues gjithashtu konstaton që sipas dëshmive që ka ofruar OE ankues plotëson dhe tejkalon këtë kriter sipas kërkesës së AK-së, që lidhet me referencat dhe qarkullimin e mjeteve për tri vitet e fundit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Nuhi PACARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Kuvendi i Republikës së Kosovës"

1x1 OE - N. T. "Info Com"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.